

Këtu në Tetovë, në sallën e restorantit "Arena", u dëgjuan këngë për "Manastirin...", "Tetovën...", "Delete ja parçete ja...", për mërgimin dhe shumë të tjera në gjuhën maqedonase, ose "Krisi pushka...", "Hasan aga", dhe shumë këngë tjera karakteristike për kulturën dhe melosin shqiptar, si dhe këngë dhe valle nga hapësirat e ish Jugosllavisë, dhe tërë Ballkanit

Nga i njëjti vend të dëgjohen këngët e gjuhëve dhe traditave të të gjitha nacionaliteteve në Maqedoni dhe në të njëjtën valle, dorë për dorë, njëri afër tjetrit, të gjenden në laramani jo vetëm burra e gra, por edhe nga të gjitha nacionalitetet, ishte fotografia e vërtetë për takimin multi-etnik të pensionistëve që më 20 prill 2018, që u mbajt në Tetovë. Këtë qytet, por edhe tërë këtë rajon e karakterizon pikërisht lloj-llojshmëria e këtillë, multi-etniciteti, multikultura, kualitete të cilat në të kaluarën ka patur tentime të dëmtohen, por çdoherë ka fituar - njeriu dhe njerëzimi. Ndoshta edhe nga deklaratat e të gjithëve, duhet të nxirren porosinë, ose siç thotë kryetari e Komunes së Tetovës, Teuta Arifi, "të gjithëve ju shoh si prindërit e mi", ndërsa Dragi Argirovski, kryetari i LSHPM u shpreh se "prezenca e njerëzve me karakter dhe dëshirë për jetë të përbashkët dhe

TAKIME MULTIETNIKE TË PENSIONISTËVE

## POROSI PËR GJENERATAT E REJA



transmetim të atmosferës së tillë deri te gjeneratat më të reja".

Këtu në Tetovë, në sallën e restorantit "Arena", u dëgjuan këngë për "Manastirin...", "Tetovën...", "Delete ja parçete ja...", për mërgimin dhe shumë të tjera në gjuhën maqedonase, ose "Krisi pushka...", "Hasan aga", dhe shumë këngë tjera karakteristike për kulturën dhe melosin shqiptar, si dhe këngë dhe valle nga hapësirat e ish Jugosllavisë, dhe tërë Ballkanit. Ndoshta kulm i gjithë kësaj ishte kur nga goja e këngëtares nga Gostivari Elena Jakimovska dëgjuam "Një është Zoti - Një është Allahu" si tërësi e një kënge, si himni dhe dhe vërtetim për bashkëjetesë dhe bashkësi për të gjithë ata që jetojnë në këto hapësira.

Me zgjedhe të lirë, biseduam

me dy pjesëmarrës në takim. Petar Zahariev, kryetar i SHP Negotinë na tha se deri tani ka marrë pjesë në të gjitha këto takime dhe çdoherë ka krijuar miqësi dhe shoqërime të reja.

"Takime të këtilla ose të ngjashme mbahen edhe në rajonet tjera të Maqedonisë, por ky i Tetovës me të vërtetë është për shembull. Kam nderin të jem pjesëmarrës dhe takimin e kam shumë për zemër. Pande Çoçkovski nga shoqata e pensionistëve të luftës i mahnitur ka folur për takimin.

"Manifestimet e këtilla duhet të mbahen çdo ditë e më shumë në Maqedoni, ndërsa ne të gjeneratës së tretë të transmetojmë monolititetin dhe pasurinë tonë nga jeta e përbashkët e të rinjve. Nuk ka pasuri më të madhe sesa ajo që këtu

përçohet në gjuhët prej më të ndryshmeve dhe me shfaqje të përbashkët. Këtu të gjithë pensionistët jemi të barabartë dhe në gjuhën e përbashkët argëtohem dhe gëzohemi që jemi së bashku".

Për herë të parë, në këtë takim multi-etnik të shtatë me radhë, morën pjesë edhe pensionistët nga Kosova. Kjo ishte shenjë se takimi ngadalë por sigurt do të pushtojë hapësirat ballkanike dhe do të paraqet shembullin për jetë të përbashkët dhe besim të ndërsjellë edhe jashtë kufijve të vendit tonë.

Mustafa Rushiti (Obiliq) na deklaroi: "Me SHP Tetovë kemi nënshkruar Memorandum për bashkëpunim", ndërsa ajo do të thotë edhe afërsi të pensionistëve nga Maqedonia dhe Kosova. Prezenca jonë në këtë takim është fillimi i veprimta-

risë sonë të përbashkët dhe bashkëpunimit të mëtutjeshëm në interes të pensionistëve të të dyja shoqatave".

Musa Jorganxhiu (Prizren) na tha: "Sharri nuk na ndanë, por na bashkon. Lehtë do ta kalojmë që të jemi së bashku, të shoqërohemi dhe të pasurojmë përmbajtjen e ditëve tona të pensionistit, të jetës sonë të gjeneratës së tretë. Për herë të parë jam në një takim të këtillë dhe me kënaqësi të madhe po e përjetoj. Do të transmetojmë këto përvoja edhe tek ne".

Se pensionistët nga Maqedonia japin kontributin e tyre në jetën e përbashkët në Ballkan, Dragi Argirovski, kryetari i LSHPM e ilustronte me pjesëmarrjen e tyre në festivalin ndër-kombëtar për gjeneratën e tretë të jetës në Lubjanë, Republika e Sllovenisë. Ai shpreh se edhe këtu në Tetovë, një ditë do të mbahen takimet e pensionistëve nga i tërë Ballkani. Shaban Azizi, kryetari i SHP Tetovë gjatë bisedës na tha se do të zgjerohet kuptimin e ekskursioneve në vendet fqinje, dhe pensionistët e shoqatës do të shkojnë edhe më larg, dhe jo vetëm në vendet siç është rasti për momentin, Serbi, Bullgari dhe Shqipëri. Azizi në fund shprehu kënaqësinë e tij me fjalët: "Më vjen mirë që pikërisht në Tetovë po ndodhë bashkëpunimi i këtillë i personave të gjeneratës së tretë në vendin tonë. Kjo më bën krenar dhe më jep gëzim!" (Gjoko Eftoski)

GANIU PRITI PENSIONISTËT

## Bashkë me Çairin për jetë më të mirë

"Çdoherë do t'i ndihmojmë më të moshuarit, për ata të cilët me angazhimin e tyre jetësor kanë kontribuar për zhvillimin e komunës sonë", tha kryetari Visar Ganiu, duke falënderuar për mirënjohjen dhe monografinë, për të cilat tha se kanë rëndësi shumë të madhe, dhe premtoi bashkëpunim edhe më të madh në të ardhmen me pensionistët

Komuna e Çairit është një prej komunave në vend, e cila në kontinuitet, me përkushtim dhe me interesim të madh përcjellë dhe mbështetë aktivitetet e Shoqatës së pensionistëve Çair. Kjo mes tjerash u tha në takimin që u mbajt



më 8 maj të këtij viti mes përfaqësuesve të Shoqatës së pensionistëve Çair dhe Kryetarit të Komunes së Çairit, Visar Ganiu. Si shenjë falënderimi për mbështetjen që kryetari dhe komuna në kuadër të mundësive të tyre ua japin pensionistëve, kryetari i Shoqatës Mentor Qoku, kryetari Ganiu i dhuroi mirënjohje, kopje të monografisë së LSHPM në gjuhën shqipe me

përkushtim nga kryetari Argirovski, kopje të gazetës "Penzioner Plus", ku është vendosur teksti për revynë folklorike, ku prezent ishte edhe vet kryetari i komunës, ndërsa nikoqir ishte shoqata e pensionistëve Çair dhe disa fotografi me kryetarin e komunës nga revyja.

"Sot kemi realizuar takim me përfaqësuesit e SHP Çair, në të cilin kemi biseduar për atë se çka në të

ardhmen mund të bëjë vetëqeverisja lokale për të ndihmuar në lidhje me kualitetin e jetës së pensionistëve tanë. Çdoherë do t'i ndihmojmë më të moshuarit, për ata të cilët me angazhimin e tyre jetësor kanë kontribuar për zhvillimin e komunës sonë", tha kryetari Visar Ganiu, duke falënderuar për mirënjohjen dhe monografinë, për të cilat tha se kanë rëndësi shumë

të madhe, dhe premtoi bashkëpunim edhe më të madh në të ardhmen me pensionistët.

Kryetari Qoku, duke iu falënderuar për mbështetjen dhe angazhimin personal të kryetarit, tha se pensionistët dinë të vlerësojnë dhe se ajo i inkurajon që të përpiqen në arritjen e sukseseve edhe më të mëdha. Kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, i shoqëruar me një pjesë të bashkëpunëtorëve të tij më 27 prill 2018 vizitoi shtëpinë e personave të moshuar "Lika Çopova" në Fushë Topanë. Qëllimi i kësaj vizite ishte dhënia e mbështetjes së projektit të organizatës joqeveritare për lëvizje globale humanitare, gjatë së cilës vizitë ai dhuroi katër karrige multifunksionale për katër persona të moshuar dhe në gjendje jo të mirë në shtëpi. Më pastaj, udhëheqësi i shtëpisë Rauf Hamidi e falënderoi kryetarin për mbështetjen dhe ndihmën që e dha, si dhe e njoftoi me kushtet jetësore në shtëpi.

(Vasil Paçemski)